

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-2012, nenit 8. të Rregullores mbi themelimin e mardhënies së punës në KRU "Hidromorava"- SH.A. Gjilan dhe nenit 5. Të Udhëzimit administrativ Nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, KRU "Hidromorava"-SH.A, në Gjilan shpall

KONKURS PUBLIK

I.Për vendin e lirë të punës në KRU "Hidromorava"-SH.A në Gjilan, për këtë pozitë:

1.1 Një (1) ekzekutues në KRU "Hidromorava"- SH.A, në pozitën Zyrtar për Burime Njerëzore.

- Përgatitja profesionale/shkollore: Diplomë universitare- fakulteti juridik, administratë publike.
- Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune në lëmin e burimeve njerëzore apo të ngjajshme.
- Numri i kryesve: një /1/
- Kohëzgjatja e kontratës së punës : Me kohë të caktuar (me periudhë provuese prej gjashtë (6) muaj);
- Paga: 600,00 € (bruto)

II. Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Shkathhtësi në planifikim të punës;
- Të mos jetë nën hetime apo të ketë qenë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter-programi Microsoft-Office.

III. Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Bën vlerësim të rregullt stafit dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara;
- Siguron ndihmë juridike, shërbime dhe këshilla ligjore për menaxhmentin;
- Në koordinim me Menaxherin e Burimeve Njerëzore, angazhohet në sjelljen e rezultateve sa më optimale krijon ambient pune pozitive dhe angazhuese në Divizion;
- Përcjell dhe mat performacën e punëtorëve;
- Bashkëpunon me menaxhmentin dhe kolegët tjerë në mënyrë që të siguroj që të gjitha vendimet dhe veprimet e menaxhmentit të ekzekutohen në interesin më të mirë të Kompanisë si dhe të krijoj një mardhënie bashkëpunimi, kohezioni dhe punë në grupe në mes të menaxhmentit dhe palëve tjera relevante;
- Udhëheqë departamentin në mënyrë efektive dhe vepron në të mirën e Kompanisë, me qëllim zvogëlimin të shpenzimeve dhe krijimit të disiplinës në punë;
- Krijon politika të avansuara në mënyrë që Kompania të avancoj përgatitjen e personelit të administratës, çështjes ligjore, procedura administrative, arkiv dhe çështje tjera që hyjnë në kuadër të detyrave të Departamentit;

- Për punët e Departamentit harton raporte të rregullta dhe sipas nevojës;
- Kujdeset për aplikimin e akteve normative në praktikë;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtëpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Menaxherit të Divizionit Administrativ dhe Burimeve Njerëzore.

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartëcekur duhet t'i kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm si vijon:

- Dëshmi të kualifikimit shkollor, fotokopje e noterizuar;
- Dokumentin e identifikimit (kopje të letërnjoftimit, pasaportës);
- CV- (të dhënat personale);
- Dëshminë e përvojës së punës (përmes Trustit pensional);
- Çertifikatën se aplikuesi nuk është nën hetime dhe nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale (Çertifikata nxirret në Gjykatën Themelore në Gjilan);

Çertifikatën mjekësore (për shkak të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve pjesëmarrës në konkurs në fund të procedurës rekretuese i /e njejta/i do të kërkohet vetëm nga kandidati i pranuar në punë).

Aplikimi bëhet online përmes këtij e-maili zyrtar : puna@kru-hidromorava.com.

Konkursi publikohet përmes web-faqes zyrtare të Kompanisë KRU “Hidromorava”- SH.A. Gjilan, <https://kru-hidromorava.com/konkurse> ku mund të shkarkohet formulari i aplikimit për punësim.

Afati i aplikimit është 15 ditë nga dita e shpalljes publike të konkursit në mjetet e informimit publik, në linkun e shpalljeve publike të kompanisë puna@kru-hidromorava.com nga data 06.08.2024 deri më 20.08.2024, në ora 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranoen , kurse ato të mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën që i plotësojnë kushtet e Konkursit ftohen për test me shkrim dhe intervistës me gojë dhe njoftohen për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së testimit me shkrim përmes postës elektronike dhe individualisht.



KRU “Hidromorava”- SH.A.

PS: Këshillë për të gjithë aplikuesit që të i përmbahen kushteve të parapara në Konkurs dhe të bashkangjesin dokumentacionin e kërkuar në Konkurs.